

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRIMIN

№/faq/Br. ser. 959
Datë/Date: 16.05.2024



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 16.05.2024

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 12, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, Rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për projekt-propozimet e OJQ-ve dhe individëve në fushat e kulturës, rinisë dhe sportit;
2. Për implementimin e thirrjes publike zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo-Qeveritare dhe individëve si vijon:
 - 2.1 Për realizimin e mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve për projekt-propozimet në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 2.2 Mjetet financiare për mbështetjen financiare tërhiqen nga kodi i subvencioneve për mbështetjen e entiteteve jopublike dhe individëve që promovojnë avancimin, fuqizimin dhe masovizimin e kulturës, rinisë dhe sportit;
3. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është 7 ditë pune dhe fillon në ditën e publikimit të thirrjes publike. Afati i fundit për dorëzim të projekt-propozimeve është deri me 24.05.2024
4. Organizata Jo-qeveritare mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një ditë dhe maksimumi 5 muaj .
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim.
Dokumentacioni i kompletuar në zarfë të mbyllur gjithashtu në usb e cila duhet të jetë brenda zarfit duhet të dorëzohet në adresën e komunës rruga 'Tahir Zëmaj' në Zyrën pritëse për shërbimin e qytetarëve në objektin e komunës ose përmes postës. Çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrën elektronike në email-adresën agron.breznica@rks-gov.net.
6. Vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve e bënë komisioni vlerësues, nëse i plotësojnë kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit një të vendimit.

7. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të Organizatave Jo-qeveritare.
8. Pasi të merret vendimi për financim për aplikuesin e suksesshëm që mund të përkrahjet nga kategoria e subvencioneve, projekti i të cilit i plotëson kushtet e financimit, udhëheqësi mbështetur ne rekomandimin e Komisionit Vlerësues merr vendim për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të Organizatave Jo-qeveritare dhe individëve që merren me përkrahjen, fuqizimin dhe masovizimin e kulturës, rinisë dhe sportit.
9. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë, rini dhe Sport e Komunës së Fushë-Kosovës.
10. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Sqarim: OJQ-të të cilat nuk i kanë mbyllur projektet paraprake (dorëzuar dëshminë e realizimit të projektit dhe raportin financiar) nuk do të shqyrtohen fare nga komisioni për vlerësim.

Akti i dorëzohet:

- 1 x Kryetarit të Komunës**
- 1 x Drejtorisë së FB**
- 1 x Drejtorisë së KRS**
- 1 x Arkivit**



Kryetari i Komunës
Burim Berisha